



| | | | |
|---|-------------------------------------|--------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar / Priljen / Prodato / Received / Delivered | 20.09.2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit | Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No. | Shkencë Punëtq. Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKPMShCK | 5523/2022 | | 119 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 52 / 2022
Datë: 20.09.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafi 1.6, nenit 20 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 1, 2, 4 dhe 5, nenit 14 paragrafi 1 të Rregullore Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave të Legjislacionit për Shërbimin Civil, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mbledhjen e trembëdhjetë (13) të mbajtur më datë 20.09.2022, mori këtë:

VENDIM

- Aprovohet** Raporti i Monitorit të Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- Obligohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Jeton KOCA
Kryetar i KPMSHCK-së

Vendimi i dërgohet

- Ministres të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Menaxherit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



| | | | |
|---|---------------------------------|------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorëzuar Punë/Procedurë Received/Delivery | 20.09 | 2 | viti god. year |
| Organ/Njësia Organ/Unit | Nr. Prot. Pr. 4 Prot. No. | Shtesa Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity |
| SKIMSHK | 5523/2022 | | 1/11 |

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT TË

JASHTËZAKONSHËM

në

MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS

Prishtinë, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|-------|
| Hyrje | 3 |
| Funksioni i monitorimit..... | 4 |
| Objektiva dhe metodologjia e monitorimit..... | 5 |
| Fusha e monitorimit..... | 6 |
| Gjendja faktike..... | 7 |
| Qëndrimet e Këshillit lidhur me legjislacionin e aplikueshëm..... | 8-9 |
| Konstatime dhe rekomandime..... | 10-11 |

DUKACJINI

Protected with free version of Watermarkly. Full version doesn't put this mark.

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tutje referuar si Këshilli*) është institucion i themeluar me Kushtetutë, me mandat specifik për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Këshilli, mandatin e tij kushtetues, *sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil* e realizon përmes funksioneve themelore të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.*

Këshilli, funksionet dhe përgjegjësitë themelore i ushtron në pajtim me:

- *Kushtetutën e Republikës së Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë;*
- *Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;*
- *Ligjet e veçanta të institucioneve përkatëse;*
- *Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;*
- *Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;*
- *Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.*

FUNKSIONI I MONITORIMIT

Krahas funksionit të shqyrtimit dhe vendosjes se ankesave të nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, Këshilli ushtron edhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civile.

Ketë funksion e ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Këshilli, përmes ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyrë zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civile me qëllim të krijimit të një administratë publike, profesionale dhe efikase, sipas standardeve me të mira evropiane.

Funksioni i monitorimit ushtrohet përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil.

Këshilli, në procesin e monitorimit të institucioneve të administratës publike përgatit raport me të gjetura dhe rekomandime dhe nxjerr vendim, të cilin së bashku me raport ia dërgon institucionit përkatës, i cili është i obliguar për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Përmes ushtrimit të funksionit të monitorimi të institucioneve të administratës publike Këshilli siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë në realizimin e objektivës aplikohet procedura e kombinimit të mostrave sipas gjykimit dhe rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe duke u mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

Në rastin konkret, monitorimi është zhvilluar përmes intervistës së zyrtareve përgjegjës në organin përkatës të punësimit dhe përmes shqyrtimit dhe analizimit të dokumenteve të siguruara nga organi i punësimit, lidhur me procedurën përkatëse të rekrutimit.

DUKAGJINI

Protected with free version of Watermarkly. Full version doesn't put this mark.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, me qëllim të ushtrimit të funksionit të monitorimit të institucioneve të administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit.

Sipas Rregullores Nr.04/2018 për procedurën e monitorimit në institucionet e administratës publike lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, fushat të cilat monitorohen nga Këshilli janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Rastet e paraqitura lidhur me ngacmimet seksuale në institucionet e administratës publike;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Monitorimin e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Mirëpo, në këtë proces të jashtëzakonshëm, fushe e monitorimit ka qenë vetëm procedura e rekrutimit e zhvilluar sipas Konkursit publike të shpallur me datë 01.07.2022 për rekrutimin e tridhjetedy (32) zyrtarëve të misionit diplomatik, dhe rrjedhimisht në këtë raport ofrohen të dhënat lidhur me gjetjet, konstatimet dhe rekomandimet lidhur me konkursin e datës 01.07.2022 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

GJENDJA FAKTIKE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.08.2022 ka mbajtur mbledhjen e rregullt në të cilën mbledhje është diskutuar dhe rrjedhimisht miratuar kërkesa për monitorim të jashtëzakonshëm lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së procedurës së rekrutimit të shpallur me datë 01.07.2022 nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për rekrutimin e tridhjetedy (32) zyrtarëve të misionit diplomatik.

Në mbledhjen e mbajtur me datë 17.08.2022 me Vendimin me Nr.51/2022 është emëruar Kolegji për zhvillimin e procedurës së monitorimit të jashtëzakonshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Kolegji i Këshillit, më datë 23.08.2022 ka realizuar vizitën e monitorimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ku është pritur nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Menaxheri i Burimeve Njerëzore.

Gjatë vizitës monitoruese dhe rrjedhimisht shkresave të administruara, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 01.07.2022 ka shpallur konkurs publikë për rekrutimin e tridhjetedy (32) zyrtarëve të misionit diplomatik. Sipas shkresave të lendes konkursi në fjalë është shpallur në mbështetje të nenit 19 dhe 20 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2009 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ nr.02/2012 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.03/2009 për Procedurat e Emërimit të Kandidateve për Nëpunës të Misionit Diplomantik, Planin e Personelit 2022 si dhe Vendimin e Nr.2394 të datës 30.06.2022 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Konkursi është shpallur në web faqe të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, por jo edhe në Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ).

QËNDRIMI I KËSHILLIT LIDHUR ME LEGJISLACIONIN E APLIKUESHEM

Kolegji i Këshillit duke iu referuar Aktgjykimit në rastin Nr.KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës konstaton se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020, dhe i njëjti si i tillë ka krijuar bazën ligjore për punësimin e zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës, të bazuar në merita, integritet moral, paanësi dhe qëndrueshmëri.

Me dispozitat e ligjit përkatës, respektivisht nenin 2 paragrafi 3 të këtij ligjit është përcaktuar se: *Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, ndërsa me nenin 4 paragrafi 1 të këtij ligj është përcaktuar se: Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik ..., janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë.*

Për sa me sipër Kolegji i Këshillit e vlerëson si të pakontestueshëm faktin se nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik janë nëpunës civilë me status të veçantë, dhe si rrjedhojë në raport me të njëjtit aplikohen dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë, dhe dispozitat e ligjit të veçantë.

Mirëpo, duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku është përcaktuar se rregullimi me ligj të veçantë i elementeve nga marrëdhënia e punës për nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik duhet të jetë në pajtueshmëri me parimet e përcaktuara me ligjin për zyrtarët publikë dhe mund të rregullohen ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: *kushtet e veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimi profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, si dhe duke ju referuar nenit 32 paragrafi 3 të këtij ligji ku është përcaktuar se: Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji, Kolegji i Këshillit vlerëson se me ligj të veçantë mund të parashihen kushte të veçanta apo shtese të rekrutimit për nëpunësit civil me status të veçantë, rrjedhimisht procedura e pranimit duhet të shpallet dhe të zhvillohet sipas dispozitave të ligjit bazik, duke aplikuar kushte të veçanta apo shtese të rekrutimit e të cilat duhet të përshkruhen në shpalljen e konkursit të publikuar në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit – SIMBNJ.*

Sipas nenit 38 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë - një pozitë profesionale e lirë në kuadër të shërbimit civil, duke përfshi edhe pozitën e nëpunësit profesional të misionit diplomatik, fillimisht plotësohet përmes procedurës së lëvizje brenda kategorisë së njëjtë dhe në këtë rast procedura e përzgjedhjes organizohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit ku është pozita e lirë, ndërsa në rast së plotësimi nuk mund të behët sipas kësaj procedure atëherë

plotësimi i pozitës së lirë bëhet përmes procedurës së pranimit në pajtim me dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Me dispozitat e nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është një sistem qendror elektronik për të gjitha institucionet publike të Kosovës, i cili shërben si ueb faqe unike e procedurave të konkurrimit dhe emërimit për nëpunësit civilë, nëpunësit e shërbimeve publike dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës, dhe bazë unike e të dhënave profesionale dhe të dhënave të tjera për marrëdhëniet e punës për çdo punëtor të një institucioni publik, përfshirë këtu edhe historikun e tyre të punësimit.

Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore të gjitha institucionet publike (përfshirë institucioneve si në pikën III të Aktgjykimit në rastin Nr.KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese) janë të obliguara që njoftimet lidhur me fillimin e procedurës së rekrutimit t'i shpallin në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ).

KONSTATIME DHE REKOMANDIME

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur së Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datë 20.07.2022 në SIMBNJ ka publikuar njëmbëdhjetë (11) shpallje të rekrutimit për ngritje në detyrë, dhe atë për pozitën e punës: Udhëheqës i Divizionit për Organizatën e Kombeve të Bashkuara; Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë; Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Kulturore dhe Sportive; Udhëheqës i Divizionit për Korrespondenca dhe Privilegje Diplomatie; Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Publike dhe Digjitale; Udhëheqës i Divizionit për NATO; Udhëheqës i Divizionit për Organizata Ndërkombëtare; Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit; Udhëheqës i Divizionit për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare; Udhëheqës i Qendrës për Menaxhimin e Krizave; dhe pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun.

Ndërsa nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit ka gjetur së Konkursi për tridhjetedy (32) zyrtarë të misionit diplomatik i publikuar me datë 01.07.2022 në ueb faqen e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk është shpallur në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit – SIMBNJ.

Konstatim 1: Kolegji i Këshillit konstaton së Shpallja e rekrutimit për tridhjetedy (32) zyrtarë të misionit diplomatik është bërë në kundërshtim me nenin 17 paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Rrjedhimisht sipas vlerësimit të Kolegjit kjo mënyrë e shpalljes së rekrutimit është në kundërshtim me parimet e pranimit të zyrtarëve publike të përcaktuara me nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji i Këshillit, po ashtu nga shqyrtimi i shkresave të administruara ka gjetur se procedurës së rekrutimit për tridhjetedy (32) zyrtarë të misionit diplomatik nuk i ka parapri një procedure e brendshme e lëvizjes paralele në kuadër të shërbimit civil.

Konstatim 2: Shpallja e rekrutimit për tridhjetedy (32) zyrtarë të misionit diplomatik është bërë në kundërshtim edhe me nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Rekomandim 1: Rekomandojmë Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për anulimin e Konkursit publikë të shpallur me datë 01.07.2022 për rekrutimin e tridhjetedy (32) zyrtarëve të misionit diplomatik.

Rekomandim 2: Rekomandojmë Menaxherin e Personelit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që plotësimi i një pozite të lirë në kuadër të shërbimit civil, përfshirë këtu edhe pozitën e nëpunësit profesional të misionit diplomatik, fillimisht të bëhet përmes procedurës së lëvizje brenda kategorisë së njëjtë në përputhje me nenin 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa në rast së plotësimi nuk mund të bëhet sipas kësaj procedure atëherë plotësimi i pozitës së lirë të bëhet përmes procedurës së pranimit në pajtim me dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Po ashtu i njëjti rekomandohet që të gjitha shpalljet e rekrutimit t'i publikoj në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), siç përcaktohet me nenin 34 paragrafi 4 dhe nenin 38 paragrafi 3 ndërlidhur me nenin 17 paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Avdyl BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI



Kryetar i Kolegjit



Raporti i dërgohet:

- *Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK.*

DUKACJINI

Protected with free version of Watermarkly. Full version doesn't put this mark.

